



Planuar / Dorezuar Prijemno/Prodato Received/Delivery	03.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1142/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.64/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari, Jeton Koca-anëtarë, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.64/2022 të datës 26.01.2022 të parashtruar nga ankuesja

Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.64/2022 e datës 26.01.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna Obiliqit, bazuar në shkresat e lëndës sipas njoftimit të datës 09.12.2021 në Sistemin e Menagjimit të Informimit të Burimeve Njerëzore, me datë 31.12.2021, ka hapur konkursin e jashtëm për pozitën "Zyrtar për arkiv 3" në të cilin konkurs me datë 06.01.2022 ka aplikuar edhe ankuesja

Komuna e Obiliqit me datë 21.01.2022 ka marr vendimin me numër XII-30 me të cilin ia ka refuzuar aplikacionin ankueses me arsyetim se kandidatja nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e konkursit, sepse nuk ka fushën e kërkuar të përgatitjes profesionale.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër XII-30 të datës 21.01.2022 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Obiliqit me datë 25.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komunën e Obiliqit.

Ankuesja me datë 26.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër vendimit të datës 21.01.2022 për refuzimin e aplikacionit nga ana e Komunës së Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Obiliqit, ndërsa me datë 11.02.2022 Këshilli ka pranua përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 677/2022, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 355/2022 të regjistruar me numër A.nr.64/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit XII-30 të datës 21.01.2022 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Obiliqit; Konkursin për pozitën " Zyrtar për Arkiv" i hapur me datën 31.12.2021 deri me datën 11.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 401/2022 të datës 28.01.2022; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 677/2022 të datës 11.02.2022; Vendimin me numër XII-67 të datës 28.01.2022 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Obiliqit; Formulari i datës 25.01.2022 për kërkesë/ankesë në Komunën e Obiliqit; Ankesën e datës 26.01.2022 drejtuar Komunës së Obiliqit; Cv- e ankueses; Letër rekomandimin e datës 01.11.2017 lidhur me përfundimin e praktikës së ankueses në Agjencinë Shtetërore për Arkiva; Diplomën universitare të datës 10.02.2016 të ankueses me të cilën mori titullin Bachelore i Historisë; Emalin e datës 18.02.2022 me numër të protokollit 892/2022 lidhur me provat shtesë të kërkuara nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 21.01.2022 me numër XII-17; Lista e Aplikativë përmes sistemit SIMBNJ; Përgatitjet shkollore/ Diplomat e shkollës së mesme për të gjithë kandidatet të cilët kanë hyrë në listën e ngushte;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuese *është e pa lejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin për pozitën " Zyrtar për Arkiva 3", në pajtim me nenin 15 paragrafi 6 të kësaj rregulloreje ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, mirëpo ende pa u vendosur për ankesën e saj, me datën 26.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Në bazë të nenit 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet që: *"...Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj"*, kështu që bazuar në përgjigjen në ankesë të Komunës së Obiliqit të datës 11.02.2022, përveç provave të tjera ka përcjell edhe Vendimin me Nr. XII-67 të datës 28.01.2022 për refuzimin e ankesës së datës 25.01.2022 të ankueses.



Bazuar në këtë dispozitë ankuesja fillimisht është dashur që të pres afatin ligjor për shqyrtimin e ankesës së saj, e pastaj varësisht nga përgjigja e institucionit të filloj ankimin me ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo meqë e njëjta nuk ka vepruar në këtë formë, një ditë pas parashtrimit të ankesës në Komunën e Obiliqit të datës 25.01.2022, ankuesja me datë 26.01.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji, konstaton se, ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e para aftëshme dhe si e tillë është parashtruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me nenin 31 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet".*

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.64/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit;
- Arkivit të KPMSHCK-së